

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-200/2015

**Prishtinë,
17 Janar 2018**

Në çështjen juridike të:

M. V.

Pala ankuese

Z.D.

Pala Përgjegjëse

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Krassimir Mazgalov Gjyqtar i EULEX-it dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, duke vendosur me ankesën ndaj vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, nr. KPCC/D/A/228/2014 (lënda e regjistruar në AKP me numër KPA08814) i datës 13 Mars 2014, pas shqyrtimit të mbajtur më 17 Janar 2018, mori këtë

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si pabazuar ankesa e **M. V.** kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. **KPCC/D/A/228/2014**, i datës 13 Mars 2014.
2. Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. **KPCC/D/A/228/2014**, i datës 13 Mars 2014, për sa i përket lëndës **KPA08814**.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 31 Janar 2007, **M. V.** në tekstin e mëtejshëm: pala ankuese), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku pretendon bashkepronësinë prej 1/3 dhe kërkon ri-posedimin e ngastrës me nr. 694/1(1211/3) me sipërfaqe prej 1.65.56 ha, që ndodhet në fshatin Marmull/Marmule, Gjakovë/Djakovica (në tekstin e mëtejshëm: prona e kërkuar). Kërkesa është regjistruar në AKP me numrin KPA08814.
2. Pala ankuese pretendon se e ka fituar pronësinë e 1/3-së së pjesës ideale, me Aktvendimin e rregullimit të tokës përmes Komisionit dhe se tani prona është e zënë dhe kërkon kthimin e posedimit.
3. Për ta mbështetur kërkesën e tij, pala ankuese ka dorëzuar dokumentet në vijim:
 - Aktvendim mbi ndarjen e tokës përmes komasacionit 019-161/228 datë 24 Gusht 1997 me të cilën pjesëmarrësve në Komasacion. Palës ankuese dhe dy motrave të tij ju ndahet prona e kërkuar në vend të ngastrës 228;
 - Kopje e planit lëshuar nga Drejtoria Gjeodete Komonale e Gjakovës/Djakovica me 9 Qershor 1997 ku ngastra kadastrale-prona e kërkuar evidentohet në emër të Ndermarrjes Shoqërore Bujqësore “ERENIKU” Gjakovë/Djakovica;
 - Aktgjykimi P.br.261/94 i datës 19 Qershor 1997 lëshuar nga Gjykata Komonale e Gjakovës me të cilën obligohet Ndermarrja shoqërore “Ereniku” t’ia njeh pronësinë paraqitesit të ankesës për ngastrën e marrë në këmbim me komasacion;
 - Letërnjoftim i lëshuar me 2 Mars 2009 nga autoritetet paralele të Serbisë.
4. Më 23 Maj 2013, AKP-ja ka bërë njoftimin e kërkesës duke vendosur një afishe në pronën e kërkuar. Njoftimi dhe vërtetimi i kërkesës është bërë përmes GPS koordinatave dhe prona ishte gjetur tokë e kultivuar e zënë nga Gj. D. i cili pretendonte të drjeta ligjore të familjës së tij mbi pronën duke e konsideruar si pronë e paraardhësve të tij por nuk paraqet deshmë për pretendimet pronësore.
5. Në bazë të raportit përmbledhës të verifikimit të datës 22 Mars 2013 AKP-ja ka konstatuar se dokumentat e bashkangjitura në mbështetje të kërkesës si Aktvendimi i Komisionit i vitit 1997 dhe certifikata e pronësisë për ngastrën 2128 janë gjetur dhe verifikuar pozitivisht.

Certifikata e pronësisë ishte azhuruar në vitin 2009 dhe ngastra 1211/2 ishte e regjistruar si bashkepronësi e palës ankuese dhe motrave të tij me 1/3 e pjesës ideale.

6. Më 8 prill 2013 AKP-ja i kishte drejtuar Komisionit për Komasaçion në Komunën e Gjakovës një kërkesë për verifikimin e të dhenave për pronën e kërkuar. Kuvendi i Komunës së Gjakovës, gjegjësisht Komisioni për rregullimin e Tokave bujqësore me 29 Prill 2013 i është përgjigjur se ekzekutimi real i vendimit të vitit 1997 është bërë në vitin 2008.
7. Më 13 Mars 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKPK) në vendimin e vet KPCC/D/A/228/2014, e ka hedh kërkesën. Në arsyetimin e vendimit (paragrafi 18), KKPK-ja ka gjetur se pala ankuese ka deshtuar të dëshmoi se ka pas të drejtë pronësore mbi pronën e kërkuar dhe se e ka humbur si rezultat i konfliktit të armatosur ose rrethanave që lidhen me te. Rrjedhimisht kërkesa ishte hedh për mungesë kompetence të KPPK-së
8. Më 17 Nëntor 2014, vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës ankuese. Pala ankuese ka paraqitur ankesë kundër vendimi të KKPK-së më 2 Dhjetor 2014(vula e pranimit nga UNHCR zyra pronësore në Beograd është gabim “2 Nëntor 2014”).
9. Më 30 Korrik 2015 T. D. e ka pranuar ankesën por nuk është përgjigjur në të.

Pretendimet e palës ankuese:

10. Pala ankuese pretendon se vendimi i KKPK-së është i paligjshëm dhe jo i saktë sepse përmban shkelle serioze të procesit, zbatim të gabuar të së drejtës materiale, dhe se kërkesa e tij për ri-posedim nuk është vërtetuar plotësisht. Pala ankuese pretendon se ngastra e ofruar numër 1211/2 ka vlerë shumë më të vogël se ngastra 694/1 e cila i është ndarë fillimisht me komasaçionin e 1997.
11. Më tutje pala ankuese ka paraqitur mospajtim me menyrën e dërgesës së dokumentave që janë dorëzuar tek pala ankuese nga AKP-ja vetëm në gjuhën shqipe (shkresat e dorëzuara nga Komisioni për Komasaçion) dhe se perkunder faktit se edhe gjuha serbe është në përdorim zyrtar të barabartë.

Arsyetimi ligjor:

12. Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve të palës ankuese, në pajtim me nenin 12 dhe 13 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 dhe nenin 194 të Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, Gjykata gjeti se Ankesa është e pranueshme. Ajo është paraqitur brenda periudhës prej 30 ditësh sikurse parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.
13. Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe pretendimeve të palës rezulton se ankesa është e pa bazuar dhe se vendimi i KKPK-së nuk përfshinë shkelle esenciale të ligjit procedural e as zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
14. Në pajtim me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 pala ankuese ka të drejtë në urdhrin për ri-posedimin e pronës nëse dëshmon pronësinë apo të drejtën e shfrytëzimit të pronës ndaj pronës së kërkuar, dhe që ai nuk ishte

në gjendje të ushtrijë të drejtat ndaj pronës për shkak të rrethanave që drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me ose janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

15. Pala ankuese e bazon të drejtën pronësore mbi dokumenta të cilat janë gjetur në sherbimet përkatëse në Kosovë edhe në vitin 2008 prona e kërkuar i është nënshtruar rirregullimit të tokës bujqësore në Komunën e Gjakovës prandaj sipas gjetjeve të AKP-së pala ankuese e ka humbur mundësinë e shfrytëzimit të pronës jo si pasojë e konfliktit por si rezultat i veprimeve administrative të autoritetit përkatës për rregullimin e tokave bujqësore .
16. Gjykata Supreme e Kosovës mori në shqyrtim edhe pretendimet e palës sa i përket përdorimit të gjuhës në procedurë nga ana e AKP-së dhe e Gjykatës dhe erdhi në përfundim se të gjitha shkresat e AKP-së dhe KKPK-së janë të shkruara në të tri gjuhët prandaj nuk gjeti se janë shkelur dispozitat e nenit 3 të Urdhresës Administrative UNMIK/Urdhresë/2007/5 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 e cila parasheh në nenin 3.1 *“Gjuhët të cilat do të mund të përdoren nga Agjencia Kosovare e Pronës në të gjitha procedurat e paraqitura në bazë të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 do të jenë ato shqipe, serbe dhe angleze”*. Kurse neni 3.2 parasheh se *“Çdo person, cili merr pjesë në procedurën para Komisionit dhe procedurën e ankesës para Gjykatës Supreme që nuk flet gjuhën e procedurave, ka të drejtë të flasë në gjuhën e tij/saj dhe të drejtën e informimit pa pagesë përmes përkthimit gojor, të dëshmitëve, fakteve dhe procedurës”*. Qartazi AKP-ja ka respektuar këtë dispozitë sepse të gjitha shkresat e dala nga AKP-ja kanë qenë në tri gjuhë në përdorim kursen shkresat e dorëzuara nga pala ankuese kanë qenë në gjuhën serbe dhe si të tilla I janë dorëzuar palëve përgjegjëse. Njësoi edhe me shkesat e palëve tjera është vepruar. Ligji nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, në nenin 97 parasheh se vetëm *“Letërthirjet, vendimet dhe shkresat tjera gjyqësore u dërgohen palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në procedurë në gjuhën që është në përdorimin zyrtar në gjykatë”* . Provat që i bashkëngjiten kërkesave të palëve nuk përkthehen për nevojat e palëve tjera përveç për Gjykatën.
17. Gjykata Supreme e konsideronë si të drejtë konstatimin e KKPK-së se Pala ankuese ka deshtuar të tregoi të drejtën pronësore dhe humbjën e saj në lidhmeri me konfliktin e vitit 1998-1999 dhe për këtë arsye kërkesa është hedhur.
18. Si e tillë, Gjykata Supreme konsideron se Vendimi i KKPK-së është i bazuar në ligj dhe nuk përmban shkelje esenciale procedurale apo zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
19. Ky aktgjykim nuk paragjykon ndonjë të drejtë pronësore për poseduesit aktual e as që paraqet pengesë për palët për inicim të procedurës pranë organit kompetent apo gjykatës kompetente nëse e gjejnë me interes ligjor.
20. Në bazë të mësipërme dhe në pajtim me nenin 13.3 nën (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë juridike:

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike

Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX -it

Erdogan Haxhibeqiri, Gjyqtar

Bjorn Olof Brautigam, kryesekretar i EULEX –it